



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM
Nr. 56 datë 30.09.2024**

**PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË VKB NR. 55 DATË 29.12.2023 “ PËR
MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2024 DHE PROGRAMIT BUXHETOR
AFATMESËM PËRFUNDIMTAR 2024-2026 TË BASHKISË SHKODËR” I
NDRYSHUAR.**

Këshilli i Bashkisë Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 30.09.2024 me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 27, neni 54 gërma “dh” të ligjit 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; ligjit Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar; ligjit Nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; ligjit Nr. 97/2023 “ Për Buxhetin e vitit 2024”; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 9 datë 20.03.2018 “ Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar; Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 1 datë 24.01.2024”; ligjit Nr. 24/2017 “ Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit”, VKB Nr. 55 datë 29.12.2023 “ Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër”, të ndryshuar; shkresës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr. 6017/6 datë 12.09.2024 “ Mbi çeljen e fondit për investimet e kërkuara nga ju”; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 559 datë 11.09.2024 “ Për një ndryshim në Vendimin Nr. 226 datë 09.04.2024, të Këshillit të Ministrave “Për shpërndarjen dhe detajimin e fondit për financimin e projekteve të bashkive nga programi “Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes” , si dhe dokumentacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër,

V E N D O S I:

1. Miratimin e shtesës së planit të Buxhetit të Bashkisë Shkodër për projektet kapitale të Drejtorisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit AMTP si më poshtë:
 - Investimi me objekt KU-32-33 Bërdicë për zbatim të investimit në vlerën 44,539,557 me TVSH prej të cilave shuma 19,000,000 lekë për vitin 2024, shuma 22,073,730 lekë për vitin 2025, shuma 3,465,827 për vitin 2026.
2. Miratimin e përdorimit të fondit rezervë të Bashkisë Shkodër, në programin 4910, artikulli 609, miratuar nga V.K.B. nr. 55 datë 29.12.2023 “ Për miratimin e buxhetit të

vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër”, të ndryshuar në vlerën **1,209,914** lekë, për mbulimin e kostove të mbikqyrjes dhe kolaudimit të projekteve të zbatimit, të financuara me anë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 559 datë 11.09.2024 “ Për një ndryshim në Vendimin nr. 226 date 09.04.2024, të Këshillit të Ministrave “Për shpërndarjen dhe detajimin e fondit për financimin e projekteve të bashkive nga programi “Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes”, si më poshtë:

lekë				
Nr.	Nr. Programi	Aktiviteti/emertimi	Art. 231 Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara	Institucioni likuidues
1	4240 Menaxhimi i Infrastruktues së Kullimit dhe Ujitjes	P4240 QI OI A9- KU-32-33 Bërdicë <i>A1. Mbikqyrje</i> <i>A2- Kolaudim</i>	1,163,298 46,616	Bashkia Shkodër
TOTALI			1,209,914	

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Miraturar me 41 vota

Vota Pro 41

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 01.10.2024

SEKRETARE

Sabina Danaj

